

Pse përzgjedhja e seksit para lindjes shoqërohet me shkeljen e barazisë gjinore

- Aborti për shkak të **përzgjedhjes së seksit të fëmijës**, pra për arsye jo-mjekësore, është një diskriminim i vajzave dhe shkellet drejtën për barazi. Ligjet dhe politikat e shtetit shqiptar janë kundër diskriminimit të vajzave.
- Zgjedhja e gjinisë para lindjes i shton praktikën diskriminuese në rritjen e fëmijës. Procesi i shoqërizimit, mënyra se si rritemi dhe praktikën diskriminuese kulturore që kemi mësuar, shpesh ndikojnë në sistemet tona të besimit dhe vendimmarrjes. Vendi ynë karakterizohet nga një sistem familjar patriarkal ku djemtë konsiderohen të nevojshëm për të përjetësuar familjen. Në të kundërt, vajzat shihen si anëtare kalimtare të familjeve të tyre të lindjes për shkak se ato do të largohen pas martesës.

Konferenca ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin

Programi i Veprimit i Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, të vitit 1994, organizuar në Kajro (ICPD), këshilloi të eliminohen "të gjitha format e diskriminimit të fëmijës vajzë dhe të shkaqeve rrënjësore të parapëlqimit të fëmijës djalë, i cili çon në praktika të dëmshme dhe joetike për foshnjat vajza dhe zgjedhjen e seksit para lindjes" (Paragrafi 4.16). Marrëveshja me konsensus gjithashtu, thotë që "udhëheqësit në të gjitha nivelet e shoqërisë duhet të shprehën dhe të veprojnë me forcë kundër modeleve të diskriminimit gjinor brenda familjes, bazuar në parapëlqimin për djem. Një nga qëllimet duhet të jetë eliminimi i vdekshmërisë artificiale të vajzave, kudo që ekziston një model i tillë." (Paragrafi 4.17).



Çfarë mund të bëj unë?

Secili nga ne duhet të luajë rolin e tij/saj si prind, pjesëtar i familjes dhe shok. Si profesionistët, përfshi këtu mësuesit, mjekët, juristët, punonjësit e organizatave jo-qeveritare, nëpunësit e institucioneve shtetërore, të zgjedhurit në organet e përfaqësimit, ashtu dhe gazetarët, shkrimtarët dhe artistët duhet:

- Të angazhohemi për ndërgjegjësimin e njerëzve mbi çështjen e përzgjedhjes së seksit para lindjes si në shtëpi, komunitete, lagje apo në vendin e punës.
- Të ngremë zërin kundër diskriminimit, të mos e tolerojmë dhunën dhe abuzimin ndaj grave dhe vajzave, të mbështesim të drejtat e pronësisë të barabarta si për djemtë dhe për vajzat.
- Të gjejmë rrugët për të nxitur barazinë mes djemve dhe vajzave në mjedisin ku jetojmë.
- Të denoncojmë rastet e shkeljes së ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë.
- Të krijojmë grupe aktivistësh për mobilizimin e komunitetit kundër përzgjedhjes së seksit para lindjes.

Përcillini këto mesazhe tek familja juaj, të afërmit, miqtë dhe komuniteti ku jetoni.

Prindër të mirë janë ata që i respektojnë njësoj fëmijët e tyre, qofshin vajza apo djem.

Pa vajza shoqëria nuk do të ketë të ardhme.

*Duaje fëmijën tënd qoftë vajzë apo djalë!
Mos e kushtëzo dashurinë!*

Gratë dhe vajzat mund të mendojnë për të luftuar për të drejtat e tjera që iu takojnë vetëm pasi t'iu jetë siguruar e drejta për të jetuar.



PSE DO TË NA MUNGOJNË VAJZAT



Raporti gjinor

Interesi për raportin gjinor në Europën Juglindore është shfaqur kohët e fundit, pasi më parë, rritja e raportit gjinor të lindjeve nuk ka tërhequr vëmendjen e shkencëtarëve të shkencave shoqërore dhe vendimmarrësve. Pika e kthesës ishte ndoshta raporti fillestar i përgatitur në vitin 2011 për Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Europës (PACE). Rezoluta PACE u bënte thirrje autoriteteve publike dhe agjencive ndërkombëtare që të mobilizohen në luftën kundër diskriminimit para lindjes mbi baza seksi. Në të njëjtën kohë, demografët dhe antropologët vunë në dukje tiparet kryesore të përzgjedhjes së seksit para lindjes në Europën Juglindore

Raporti gjinor në Shqipëri

Në dhjetor 2011 në Shqipëri u diskutua për herë të parë në një konferencë çështja e mungesës së ekuilibrit midis dy seksëve dhe përzgjedhjes gjinore në lindje, në popullsinë shqiptare. Akademikë vendas dhe të huaj, politikë-bërës, ekspertë nga komuniteti ndërkombëtar si dhe përfaqësues të shoqërisë civile diskutuan rëndësinë dhe çështjet që lidhen me mungesën e ekuilibrit midis seksëve në popullatën shqiptare. Një nga përfundimet tronditëse të kësaj konference ishte se kuptuam sa pak njohuri kemi në lidhje me këtë fenomen që ndeshet në mjedisin specifik shqiptar dhe në përgjithësi në Ballkan.

Ç'është raporti i lindjeve sipas seksit?

- Raporti i lindjeve sipas seksit (RSL) është numri i meshkujve të lindur për çdo 100 lindje femrash.
- Niveli biologjik i RSL-së është rreth 105 lindje meshkujsh për çdo 100 femra të lindura.

Por në vende ku mund të bëhet përzgjedhja e seksit para lindjes, RSL-ja mund të arrijë deri në 110-120 dhe kjo prishje ekuilibri përcakton si rrjedhojë çekuilibrimin e raportit gjinor të grupmohave më të mëdha në dekadat e ardhshme.

Ç'është përzgjedhja e seksit para lindjes?

Përzgjedhja e seksit para lindjes është praktika e përcaktimit të seksit të embrionit apo fetusit përpara fertilizimit (nëpërmjet diagnostikimit gjenetik para mbjelljes) apo gjatë shtatzënisë (nëpërmjet ekografisë), dhe eliminimi i tij në bazë të seksit. Kjo përbën një diskriminim sistematik dhe të pakthyeshem të vajzave



Raporti midis seksëve në popullsinë e Shqipërisë

Ndryshe nga shumica e popullsive në botë, popullsia e Shqipërisë ka qenë e dominuar nga meshkujt për një kohë të gjatë. Niveli i RS-së ka qenë 101.4 pas Luftës së Dytë Botërore dhe madje është rritur në 105.3 në vitin 1990, gjatë një periudhe kur emigrimi jashtë vendit pothuajse nuk ekzistonte. Ky mbizotërim i pazakontë i popullsisë mashkullore mund të ketë pasur lidhje me nivelin e lartë të vdekshmërisë së femrave-foshnja dhe gjatë fëmijërisë.

Kjo gjendje ndryshoi në mënyrë rrënjësore gjatë viteve '90. Shkalla e rritjes së popullsisë u zvogëlua menjëherë për shkak të emigrimit në masë nga Shqipëria. Pasi emigrantët ishin kryesisht meshkuj, RS-ja e popullsisë së Shqipërisë u zvogëlua gjatë kësaj dekade duke arritur nivelin 99.5 në vitin 2000. Por tani raporti i lindjeve sipas seksit vazhdon të jetë i lartë në Shqipëri, siç del edhe nga regjistrimi i vitit 2011: **109 meshkuj për 100 femra nga 105 që është norma biologjike natyrore. RS-ja e popullsisë së Shqipërisë mbetet dukshëm më e lartë se në vendet fqinje si Italia, Greqia, Serbia dhe Mali i Zi**

Pse është kaq i lartë raporti i lindjeve sipas seksit?

Përzgjedhja e seksit para lindjes në botë bazohet gjithmonë në tre faktorë:

- Së pari, ajo shkaktohet nga parapëlqimi i djemve dhe jo i vajzave nga prindërit, gjë që i bën ata të zgjedhin fetuset mashkullore dhe jo femërore.
- Së dyti, përzgjedhja e seksit është mundësuar nga teknologjitë moderne, që bashkë me abortin, u krijon çifteve kushtet që të shmangin lindjet e vajzave kur këto nuk dëshirohen.
- Së treti, kjo situatë keqësohet edhe nga niveli i ulët i lindjeve, sepse prindërit që kanë pak fëmijë shpesh herë zgjedhin të lindin djalë.



Faktorët që nxisin fenomenin e parapëlqimit për djem

Këta faktorë grupohen në tri kategori: faktorët kulturorë, faktorët social-ekonomikë dhe faktorët që kanë të bëjnë me normat dhe presionin e komunitetit.

Faktorët kulturorë - nevoja për djem rrjedh nga rëndësia e përcimit të mbiemrit dhe identitetit të familjes te brezat pasues, si dhe nga që djemtë e kanë detyrim të mbrojnë familjen nga rreziqet dhe t'i dalin zot nderit të familjes.

Faktorët social-ekonomikë - Sipas perceptimit, djemtë kanë më shumë mundësi ekonomike sesa vajzat, pasi mund të punojnë dhe të emigrojnë, duke mbajtur financiarisht prindërit dhe tërë familjen. Përveç kësaj, djemtë kanë të drejtë të trashëgojnë tokën dhe pasurinë e familjes, sidomos në komunitetet e vogla rurale

Faktorët që kanë të bëjnë me normat dhe presionin e komunitetit - Presioni i komunitetit në lidhje me numrin e fëmijëve dhe përbërjen e familjes ka ndikim indirekt mbi parapëlqimin apo nevojën për të pasur një djalë në familje. Shoqëria shqiptare vazhdon të jetë patriarkale; ekziston ndarja e roleve gjinore në jetën publike dhe private si edhe diskriminimi gjinor, pavarësisht nga prirjet e reja sa i përket stilit të jetesës dhe marrëdhënieve gjinore.



Cilat janë ndikimet afatshkurtra dhe afatgjata të përzgjedhjes së seksit para lindjes?



Përzgjedhja e seksit para lindjes shkakton:

- Rritjen e numrit të meshkujve të lindur, por më vonë sjell rritje të RS-së së fëmijëve dhe të rriturve
- Mungesa e ekuilibrit midis popullsisë së rritur do të ndikojë në sistemin e martesës në Shqipëri, pas njëzet vitesh, për shkak të një deficiti të dukshëm të femrave në moshë për martesë. Emigrimi i meshkujve jashtë vendit dhe imigrimi i femrave janë të vetmit faktorë rregullues të këtij çekuilibri
- Teprica e meshkujve mund të ketë pasoja negative si për meshkujt edhe për femrat, duke sjellë beqaritë detyruar për meshkujt dhe dhunë gjinore dhe trafikim për femrat.